

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË ELBASAN**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Elbasan me objekt: “Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, prokurimet me fonde publike, taksat e tarifave vendore”, në Bashkinë Elbasan. dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 98, datë 30.6.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 455/9, datë 30.6.2012, dërguar z. **Qazim Sejdi**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

1. Të merren masa nga titullari i njësisë publike që të hartojë dhe miratojë strategjinë e riskut, si dhe të caktojë koordinatorin e riskut.

**Menjëherë**

2. Të merren masa për hapjen dhe administrimin e regjistrit të raportimeve dhe masave të marra për parandalimin e mashtrimit dhe parregullsive.

**Menjëherë**

3. Të dokumentohen me proces verbale zbritjet e volumeve të rezultuara nga kontrollet e mbikëqyrësve të shërbimit të pastrimit, si për sasinë e punimeve të kryera ashtu edhe për cilësinë e shërbimit duke i reflektuar dhe zbritur ato si diferencë e situacioneve mujore të paraqitura nga sipërmarrësi.

**Vazhdimisht**

4. Të sistemohen gjendjet në inventar si dhe të pasqyrohen në kontabilitet vlerat e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara sipas analizave me emërtime të sakta e të plota të objekteve. Të paraqiten me vlerën e plotë sipas situacioneve objektet e realizuara me bashkëfinancime me FZSH, të cilat paraqiten në inventar dhe në kontabilitet të vlerësuara vetëm me vlerën e kontributit të bashkisë.

**Menjëherë**

5. Të sistemohet inventari dhe gjendja kontabile e llogarisë 215 “Mjete transporti” për 17 mjete transporti në vlerën 12,008,500 lekë të përcaktuara jashtë përdorimit, duke kryer vlerësimin për pjesët e këmbimit që do të rezultojnë mbetje.

**Menjëherë**

6. Në hartimin e planit të ardhurave vendore të angazhohen specialistë nga të gjitha drejtoritë, për të shmangur maksimalisht evazionin fiskal e për të shfrytëzuar të gjitha kapacitetet ekzistuese.

**Vazhdimisht**

7. Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendoj punën me Drejtorinë e Financës dhe Policinë e Bashkisë për arkëtimin e detyrimeve të lindura nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2011 së bashku me penalitetet.

**Vazhdimisht**

8. Policia e Bashkisë së bashku me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, të evidentojnë të gjitha automjetet e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave të pa

licencuara dhe të bëhet regjistrimi i tyre, në të kundërtën të zbatohen sanksionet ligjore përkatëse.

**Vazhdimisht**

**9.** Drejtoria e Menaxhimit të Pronave të ndjekë pranë ZVRPP Elbasan procesin e regjistrimit të aseteve pronë e Bashkisë dhe të bëjë evidentimin e tyre në kontabilitet.

**Vazhdimisht**

**10.** Të plotësohen me dokumentacionin e nevojshëm tekniko-ligjor dhe ekonomik automjetet e dhëna me qira dhe mbi këtë bazë të rillojariten kontratat e qirasë.

**Menjëherë**

**11.** Të analizohen dhe të saktësohen gjobat e Policisë Bashkiake që përfitojnë falje deri më 31 dhjetor 2010 sipas nenit 19 të ligjit nr. 10418, datë 21.4.2011 dhe nenit 46 të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe të ndiqet arkëtimi i gjobave pa arkëtuara nga viti 2008 deri në vitin 2011 për 95 raste në vlerën 133,700 lekë.

**Menjëherë**

**12.** Autoriteti Vendor i Planifikimit të marrë masa për hartimin e miratimin e Planit Përgjithshëm Vendor (PPV), pasi përfundimi i hartimit dhe miratimit të PPV-së është detyrim ligjor dhe i hap rrugën zhvillimit të territorit në mënyrë të qëndrueshme, me qëllim që shqyrtimi dhe miratimi i lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit dhe lejeve të përdorimit, të bëhet duke u bazuar në kërkesat e ligjit për planifikimin dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

**Menjëherë**

**13.** Autoriteti Vendor i Planifikimit të marrë masa për hartimin e miratimin e instrumenteve të planifikimit në nivel vendor dhe ndërvendor, si Politika e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë (PZHNjV), PPV për Planifikimin e Territorit dhe Rregullorja e Planifikimit për PPV, pasi këto instrumente janë detyrim ligjor për të gjitha njësitë vendore.

**Menjëherë**

**14.** Autoriteti Vendor i Planifikimit të marrë masa, që për lejet e ndërtimit të miratuara para hyrjes në fuqi të planifikimit dhe lejet e ndërtimit që janë në zbatim, të vazhdojnë zbatimin në përputhje me kushtet e lejes së dhënë.

**Vazhdimisht**

**15.** Autoriteti Vendor i Planifikimit të marrë masa, që për ndërtimet e përfunduara para hyrjes në fuqi me efekte të plota të ligjit për planifikimin, lejen e përdorimit ta japë në përputhje me kushtet e zbatimit të lejes së ndërtimit.

**Vazhdimisht**

**16.** Të merren masa dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës prej 450,000 lekë për 6 raste të gjobave të vendosur nga INUV.

**Menjëherë**

**B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Të kërkohen në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit të shkaktuar buxhetit të bashkisë në vlerën **944,844 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, nga i cili:

- 98,400 lekë

- 43,320 lekë

- 433,600 lekë

- 204,200 lekë

si rezultat i likuidimeve të punimeve të pakryera në 4 tendera, në kundërshtim me nenet 7, 8, 9, 11, 12, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”.

- 51,997 lekë [redacted] në cilësinë e qiramarrësit,
- 24,777 lekë [redacted] i në cilësinë e qiramarrësit,
- 21,070 lekë [redacted] në cilësinë e qiramarrësit,
- 22,230 lekë [redacted] në cilësinë e qiramarrësit,

si rezultat i mos derdhjes në kohë të qirasë, në zbatim të kontratave përkatëse lidhur midis palëve.

- 45,250 lekë 13 personave sipas listës bashkëngjitur, që kanë përfituar bonuse strehimi, për shkak të mos mbajtjes të tatimit mbi të ardhurat, për marrjen banesave me qira në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

### **C. MASA DISIPLINORE**

a. Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të VKM nr. 306, datë 13.6.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

#### **a.1 “Vërejtje me paralajmërim”, neni 25, pika 3, germa b**

**zj.** [redacted] me detyrë përgjegjëse e Sektorit të financës,

**zj.** [redacted] me detyrë specialiste e financës pasi:

- nuk kanë pasqyruar saktë në inventarë dhe llogarinë vjetore aktivet e qëndrueshme të trupëzuara për vitin 2010 dhe 2011,
- nuk kanë ndjekur arkëtimet debitore për vitin 2010 dhe 2011, për mos zbatim të nenit 4 dhe 17 të ligjit nr. 10 296, datë 08.7.2010.

(Shih procesverbalet nr. 10, datë 08.5.2012 dhe 15, datë 09.5.2012).

**z.** [redacted] me detyrë specialist i zyrës së sekretarisë teknike,

**z.** [redacted] me detyrë specialist i zyrës së sekretarisë teknike,

**z.** [redacted] me detyrë specialist i zyrës së sekretarisë teknike,

**zj.** [redacted] me detyrë specialiste në zyrën e urbanistikës studimore,

**zj.** [redacted] me detyrë specialiste në zyrën e kontrollit projekteve,

**zj.** [redacted] me detyrë specialiste e zyrës së urbanistikës ligjore,

**zj.** [redacted] me detyrë ish-specialiste në zyrën e kontrollit projekteve, aktualisht specialiste urbanistike rajoni dhe

**z.** [redacted] detyrë specialist i zyrës së urbanistikës ligjore,

- për mos zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e rregullores së urbanistikës” i ndryshuar, dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërtimeve” i ndryshuar,

- për parregullsi e mangësi, në zbatimin e procedurave ligjore në shqyrtimin e miratimin e studimeve urbanistike pjesore së bashku me detyrat e projektimit, lejeve të destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij, lejeve të ndërtimit, në mbajtjen e akteve të kontrollit sipas fazave të ndërtimit, si dhe në shqyrtimin dhe dhënien e lejeve të shfrytëzimit.

**2 “Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët për një periudhë nga 30 ditë deri në një vit”, neni 25, pika 3, germa c**

- zj.** [REDACTED] me detyrë drejtore e Drejtorisë së Buxhet - financës për:
- pasaktësitë e evidentuara në kryerjen e inventarëve dhe llogarinë vjetore të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për vitin 2010 dhe 2011,
  - mos ndjekjen e debitorëve për vitin 2010 dhe 2011,
- z.** [REDACTED] me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse për:
- pasaktësitë e evidentuara në kryerjen e inventarëve dhe llogarinë vjetore të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara për vitin 2010 dhe 2011,
  - mos ndjekjen e debitorëve për vitin 2010 dhe 2011,
  - planifikimin me rezerva, mos ndjekjen e detyrimeve të prapambetura dhe mos realizimin e taksave dhe tarifave vendore,
- për mos zbatim të nenit 4 dhe 17 të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010.

- z.** [REDACTED] me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve publike,
- z.** [REDACTED] me detyrë Përgjegjës Sektori i Shërbimeve të tregut për:
- z.** [REDACTED] me detyrë Drejtor i Shërbimit të Territorit Urban,
- z.** [REDACTED] me detyrë Përgjegjës Sektori i Shërbimet të Transportit për:
- planifikimin me rezerva, mos ndjekjen e detyrimeve të prapambetura, mos realizimin e taksave dhe tarifave vendore dhe mos ndjekjen e debitorëve për vitin 2010 dhe 2011, pjesë e detyrës funksionale, e përcaktuar me VKB nr. 109, datë 28.12.2009 për vitin 2010 dhe nr. 14, datë 23.02.2011 për vitin 2011.
- z.** [REDACTED] me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës, në cilësinë e sekretarit të KRRT-së,
- për mos zbatim të kërkesave të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998 i ndryshuar, ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 i ndryshuar, VKM nr. 722, datë 19.11.1998 i ndryshuar, ligjit nr. 8934, datë 05.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisin”, ligjit nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2001,
  - për parregullsi e mangësi, në zbatimin e procedurave ligjore në shqyrtimin e miratimin e studimeve urbanistike pjesore së bashku me detyrat e projektimit, lejeve të destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij, lejeve të ndërtimit, në mbajtjen e akteve të kontrollit sipas fazave të ndërtimit, si dhe në shqyrtimin dhe dhënien e lejeve të shfrytëzimit.

**b.** Mbështetur në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Për kodin e punës” dhe nenin 8 paragrafi 4 pika 2 e kontratën individuale të punës, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore: **“vërejtje me paralajmërim për lirim nga detyra”**, për:

- z.** [REDACTED] me detyrë kryetar i Rajonit nr. 1,
- z.** [REDACTED] me detyrë kryetar i Rajonit nr. 2,
- z.** [REDACTED] me detyrë kryetar i Rajonit nr. 3,
- z.** [REDACTED] me detyrë kryetar i Rajonit nr. 4,
- z.** [REDACTED] me detyrë kryetar i Rajonit nr. 6,
- z.** [REDACTED] me detyrë agjent tregut të lirë,
- z.** [REDACTED] me detyrë agjente e tregut të lirë,
- z.** [REDACTED] me detyrë agjent i tregut të lirë,
- z.** [REDACTED] me detyrë agjent i tregut të lirë,
- z.** [REDACTED] me detyrë agjent i parkimit të automjeteve pasi:

- janë përgjegjës kryesorë për mos realizimin e taksave dhe tarifave vendore për popullatën, realizimi i të cilave për vitin 2011 është 37 për qind, pjesë e detyrës funksionale, e përcaktuar me VKB nr. 109, datë 28.12.2009 për vitin 2010 dhe nr. 14, datë 23.02.2011 për vitin 2011.
- kanë planifikuar me rezerva dhe nuk kanë ndjekur detyrimet të prapambetura të taksave dhe tarifave vendore të popullatës për vitin 2010 dhe 2011.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatmir Zilja, Xhevdet Haxhiu, Margarit Stefa, Halil Isufi dhe Xhemal Luka. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**